



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna e Istogut
Opština Istok
Istog Municipality

Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport

12 Nr 04/2026
23.02.2026

Komuna Istog, Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport në bazë të Rregullores Komunale Nr.146/2025 për ndarjen e Subvencioneve si dhe në bazë të rregullores së Ministrisë së Financave Nr. 04/2017 për kriteret standardet dhe procedurat e financimit publik të OJQ-ve shpallë:

Thirrje publike për ofrimin e mbështetjes financiare për projektet/programet e OJQ-ve për organizimin e Turnirit Memorial në Shah "UÇA 92"

- 1. Komuna e Istogut fton të gjitha organizatat jo-qeveritare të cilat veprojnë në Komunën e Istogut, programi i punës i të cilave është i fokusuar në fushën Sportit të aplikojnë për mbështetje financiare.**
- 2. OJQ-të në përputhje me këtë thirrje publike mund të aplikojnë me projektetin/programin e tyre.**

3. Dokumentet kryesore të cilat duhet të dorëzohen nga OJQ-të përfshijnë:

1. Certifikata e regjistrimit të OJQ-së.
2. Certifikata e nr. Fiscal.
3. Vërtetimin/konfirmimin e llogarisë bankare të lëshuar nga banka përkatëse (nuk pranohet kopje e kartelës bankare).
4. Kopjen e letërnjoftimit të drejtuesit të OJQ-së apo dokument tjetër identifikues valid.
5. Vërtetimin nga ATK, që dëshmon se OJQ-ja nuk ka obligime tatimore.
6. Vërtetimin nga gjykata që ojq-ja nuk është në procedura të shuarjes apo çregjistrimit.
(Pas shaplljes të rezultateve për OJQ-në fituese të projektit në fjalë)
7. Aplikacionet :
 - -Formulari i Aplikacionit për Projekt/program,
 - -Formulari i Propozim Buxhetit,
 - -Formulari i Deklaratës për Financimit të Dyfishtë,
 - -Formulari i Deklaratës se Partneritetit, (opcionale - nëse ka partneritet),
 - -Formulari i deklaratës së projekteve të financuara nga burimet publike

4. KRITERET PËR PJESËMARRJE NË THIRRJEN PUBLIKE PËR SUBVENCION, SI DHE KRITERET E PRANUESHME

1. Të drejtë aplikimi kanë OJQ-të, të cilat janë të regjistruara në Republikën e Kosovës dhe të cilat veprojnë në Komunën e Istogut së paku një vit para datës së publikimit të thirrjes publike;
2. OJQ-të, aplikuese duhet të dëshmojnë se programi i tyre i punës është i fokusuar dhe kanë përvojë në fushën për të cilën aplikojnë.
3. OJQ-të, mund të subvencionohen vetëm një herë brenda vitit për të njëjtin aktivitet.
4. OJQ-të, të cilët nuk kanë përmbyllë raportin e subvencioneve të viteve paraprake nuk kanë të drejtë të përfitojnë nga subvencionet e Komunës së Istogut në këtë thirrje;
5. Të mos kenë pranuar mjete nga burime të tjera të financimit për të njëjtat aktivitete brenda të njëjtit vit fiskal;
6. Të mos ekzistojë ndonjë konflikt interesi në mes të aplikuesit, përkatësisht përfaqësuesve/udhëheqësit të aplikuesit dhe organizatës buxhetore apo institucionit publik, sic parashihet me legjislacionin në fuqi në Republikën e Kosovës;

5 .Shuma minimale dhe maskimale për këtë aktivitet është nga 2000 deri 2500 Euro.

6. Afati për dorëzimin e aplikimeve është prej 24.02.2026 deri më 10.03.2026 në orën: 16:00.

7. Periudha e zbatimit të projektit është nga 22.03.2026 deri 05.04.2026.

8. Propozimet duhet të dorëzohen vetëm në formularët e paraparë në bazë të rregullores MF — Nr. 04/2017.

9. Dokumentet e kompletuara duhet të dërgohen personalisht ose me postë në zarf të mbyllur në zyrën e QSHQ (qendra për shërbim me qytetarë) në adresën: Komuna Istog, rruga Fadil Ferati, 31000. Procesi i pranimit, hapjes dhe shqyrtimit të aplikacioneve, kontraktimi, dhënja e fondeve, koha dhe mënyra e parashtrimit të ankesave, trajtimi i dokumenteve dhe kalendari tregues i zbatimit të thirrjes janë të detajuara në rregulloren për subvencione. Do të konsiderohen për mbështetje financiare vetëm projektet që janë të pranuar brenda afatit të paraparë me këtë thirrje publike dhe të cilat i përmbushin plotësisht kushtet e përcaktuara të thirrjes publike.

10. Të gjitha çështjet që lidhen me thirrjen publike mund të sqarohen vetëm në mënyrë elektronike, por jo më vonë se tetë (8) ditë para mbylljes së thirrjes publike, duke shkruar në email: drin.sadikaj@rks-gov.net.

Drejtori për Kulturë, Rini dhe Sport

z.Genc Ademaj

